



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0249

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi – Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “MetBat sh.p.k., me seli në Drenas, kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Asgjësimi i barnave me afat të skaduar nëpër Njësitë Shëndetësore të Burgjeve”, me numër të prokurimit 206-23-2160-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ministria e Shëndetësisë, më datën 05.06.2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e “MetBat sh.p.k., me nr. 2023/0249, e datës 02/05/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Asgjësimi i barnave me afat të skaduar nëpër Njësitë Shëndetësore të Burgjeve”, me numër të prokurimit 206-23-2160-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Ministria e Shëndetësisë, kurse Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës për këtë aktivitetin të prokurimit, Vërtetohet;

2. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konfom nenit 31 paragrafi 5 të Rregullores së Punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit;

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 15.03.2023, Ministria e Shëndetësisë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Asgjësimi i barnave me afat të skaduar nëpër Njësitë Shëndetësore të Burgjeve”, me numër të prokurimit 206-23-2160-2-2-1.

Me datë 20.04.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit të sipërsëhënuar, ku është rekomanduar për kontratë, OE “Princi Company” sh.p.k.

OE "MetBat sh.p.k.,me datën 25.04.2023, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 26.04.2023, AK - Ministria e Shëndetësisë,me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues dhe ka vërtetuar, njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "MetBat sh.p.k.,me datë 02.05.2023,ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0249, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Shërbim , vlera e parashikuar e kontratës: 12,000.00€.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 26 prill 2023 me raportin e ekspertizës. AK Ministria e Shëndetësisë,me datë 30 maj 2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE "MetBat sh.p.k.,ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 14.05.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e Operatorit Ekonomik ankues "MetBat sh.p.k.,është pjesërisht e bazuar

- mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, i datës 20.04.2023.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues, "MetBat sh.p.k., Drenas.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

OE "Met Bat sh.p.k. Glllogoc pretendon se Autoritetit Kontraktues Ministria e Shendetësisë e ka shkelur nenin 1 të LPP-së,Eksperti thekson se ndër tjera qëllim i ketij neni është të sigurojn menyre ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat që do të zbatohen , procedurat që do të ndiqen të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE,ankues si OE i eliminuarë është në harmoni me nenin 1 të LPP-së .

AK e ka eliminuar nga gara OE ankues për keto arsye :

Oferta e OE ankues u shpallë e pa pergjegjeshme sepse te pjesa Formulari i tenderit ka ofruarë çmim në total 2.40€ ndersa te totali i pershkrimit të çmimit ka ofruar çmimin 9,600.00€

AK sqaron se në Rregullorja nr. 001.2022 për Prokurim Publik, konkretisht neni 40.10.pika (b) përcakton se në rast se oferta duhet të refuzohet dhe e citon këtë paragraf të rregullores si:

40.10 Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:

a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;

b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Po ashtu oferta OE “MetBat” sh.p.k. është e papërgjegjshme, meqenëse nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 lidhur me përshtatshmërinë profesionale, konkretisht nuk e ka ofruar Licencën e kërkuar, por ka ofruar një leje mjedisore e cila nuk e plotëson kërkesën e tenderit.

Eksperti konstaton se dallimi në çmim si të formulari i tenderit dhe të përshkrimi i çmimit është mbi normën e lejuar edhe pse si gabim duket dhe shihet se është gabim, mirëpo meqë dizpozita e cekurë më lart qart e sqaron-specifikon se mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet. Andaj në rastin konkret të përshkrimi i çmimit totali me tvsh është 9,600.00€ ndërsa të Formularin e Tenderit çmimi total i tenderit është 2.40€. Andaj, eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë

Përgjigje në pretendimi nr.2 .

OE “Met Bat sh.p.k.”- Glllogoc - pretendon se Autoritetit Kontratues Ministria e Shendetësisë e ka shkelur nenin 6 të LPP-së ,

Eksperti thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të siguroj që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit, andaj trajtimi OE ankues si i eliminuar është në harmoni me nenin 6 të LPP-së.

Eksperti konstaton se eliminimi i OE ankues për arsyen e sqaruarë në pretendimin dhe përgjigjen nr 1 është në harmoni edhe me nenin 6 të LPP-së. Andaj, eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuarë

Përgjigje në Pretendimi nr.3 .

OE “Met Bat sh.p.k.”- Glllogoc pretendon se Autoritetit Kontratues Ministria e Shendetësisë e ka shkelur nenin 7 të LPP-së, eksperti thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet të trajtojnë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Ndër të tjera pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e këtij neni: AK nuk do të ekzekutoj asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të OE ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose me shumë operatorve ekonomik.

Eksperti sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues, i njëjti pretendim nuk qëndron sepse gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nuk shihet se ka pasur shkelje në dëm të OE

ankues , trajtim jo të drejtë ,sepse sikurse e sqarova në pretendimin nr 1 OE ankues ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve. Andaj,eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4.

OE "Met Bat SH.P.K."- Glllogoc - pretendon se Autoritetit Kontratus Ministria e Shendetësisë e ka shkelur nenin 59 të LPP-së.

Eksperti thekson se qellim i ketij neni është Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të Vlerësimit ,pasi ka pranuar kerkesën për rishqyrtim AK i ka shqyrtuar pretendimet dhe e ka trajtuar si të pa bazuarë kerkesen per rishqyrtim. Eksperti sqaron kronologjin e rastit OE ankues u eliminua për keto dy pika :

1. Për shkak të mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, dhe

2. Nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 lidhur me përshtatshmërinë profesionale, konkretisht nuk e ka ofruar Licencën e kërkuar, por ka ofruar një leje mjedisore e cila nuk e plotësor kërkesën e tenderit.

Autoriteti kontraktues ka sqaruar se eliminimi u bë me ketë arsytim:

Oferta e OE ankues u shpallë e pa pergjegjeshme sepse te pjesa I Formulari i tenderit ka ofruarë çmim në total 2.40€ ndersa te totali i pershkrimit të çmimit ka ofruar çmimin 9,600.00€

AK sqaron se në Rregullorja nr. 001.2022 për Prokurim Publik, konkretisht neni 40.10. pika (b) percakton se në rastë të tilla oferta duhet të refuzohet dhe e citon ketë paragraf te rregullores si:

40.10 Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:

a. Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total që është fituar duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total do të korrigjohet;

b. Në rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.

Po ashtu oferta MetBat SH.P.K. është e papërgjegjshme, meqenëse nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 lidhur me përshtatshmërinë profesionale, konkretisht nuk e ka ofruar Licencën e kërkuar, por ka ofruar një leje mjedisore e cila nuk e plotësor kërkesën e tenderit.

OE ankues nderë të tjera pretendon se:

Pika 1 . Kemi të bejm me sasi indikative sepse aneksi 1 i dosjes së tenderit tek specifikimet teknike të detyrueshme është specifikuar saktë "Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikativë, Devijimi i lejuar nga sasia totale indikativë është [+/-30%]". Nga ky fakt kuptohet se është dashur të ofertohej me çmim njësi dhe kontrata në këtë rast nënshkruhet për çmim njësi dhe jo çmim total, andaj në këtë rast vërtetohet fakti se nuk ekziston asnjë mospërputhje e çmimeve dhe se nuk ka asnjë gabim aritmetik.

Eksperit sqaron se gabimi ka ndodhur të çmimit total në Formularin e Tenderit ku në vendë se te jepet totali i çmimit është dhënë çmimi për njësi(KG) që ishte 2.40€ (ky çmim ishte i sakt për njësi sikur te pershkrimi i çmimit) mirëpo te formulari i tenderit duhet dhënë çmimin total të tenderit ashtu sikurse është dhënë çmimi total me tvsh te pershkrimi i çmimit e që ishte në vlerë: 9600.00€.

Autoriteti Kontraktues në rastin konkret bazuar ne Rregullorja nr. 001.2022 për Prokurim Publik, konkretisht neni 40.10.pika (b) .

Me të drejtë? e ka eliminuarë nga gara OE ankues pasi ka gjetur mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Pika 2

2. Nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 4 lidhur me përshtatshmërinë profesionale, konkretisht nuk e ka ofruar Licencën e kërkuar, por ka ofruar një leje mjedisore e cila nuk e plotësor kërkesën e tenderit. Autoriteti kontraktues ka sqaruar se eliminimi u bë për keto arsye :

Oferta e OE ankues u shpallë e pa përgjegjeshme sepse te pjesa i Formulari i tenderit ka ofruarë çmim në total 2.40€ ndersa te totali i pershkrimit të çmimit ka ofruar çmimin 9,600.00€

AK sqaron se në Rregullorja nr. 001.2022 për Prokurim Publik, konkretisht neni 40.10.pika (b) percakton se ne raste te tilla oferta duhet të refuzohet dhe e citon këtë paragraf te rregullores si

OE ankues nderë të tjera pretendon se:

Pika 2.

Ju sqarojmë se duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-060 për mbeturina në nenin 55 paragrafi 2 shkruan decidivisht, citojmë "Licenca për menaxhimin e mbeturinave nuk do të lëshohet për operatorët që operojnë në objektet dhe impiantet, të cilat janë të detyruar të i nënshtrohen procedurës për marrjen e lejes integruar mjedisore sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes".

Nga kjo dispozitë kuptohet qartë që Ministria nuk lëshon licencë për operatorë të cilët janë të detyruar ti nënshtrohen procedurës për marrjen e lejes së integruar mjedis sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Prandaj në këtë rast rezulton se kërkesa e dosjes së tenderit është përmbushur nga kompania jonë dhe e rëndësishme është se ne si kompani kemi të dejtë të bëjmë asgjësimin e mbeturinave spitalore, medicinale, organike të përgjithshme dhe nuk është më rëndësi emërtimi i dokumentit që e posedon kompania, Licencë apo lejen e integruar mjedisore, sepse ligji i lartpërmendur neni 55 paragrafi 2 po e cek shumë qartë që "Licenca për menaxhimin e mbeturinave nuk do të lëshohet për operatorët që operojnë në objektet dhe impiantet, të cilat janë të detyruar të i nënshtrohen procedurës për marrjen e lejes integruar mjedisore sipas Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes".

Eksperti sqaron se në rastin konkret kemi të bëjmë me një dokument ekuivalent, sepse me NJK dhe DT është kërkuar Licencë për grumbullim dhe asgjësim e mbetjeve mjeksore në përputhje

me Ligjin për mbeturinat 04 L -060 i ndryshuar dhe i plotsuar me Ligjin 08 071 ,valide të leshuar nga organi kompetent ,ndersa OE ankues ka ofertuarë me dokumentin ekivalent „Leja Mjedisore e integruar”Impianti për asgjësimin e mbeturinave spitalore ,medicinale ,organike të përgjithëshme.

Edhe Licencen edhe Lejen te dy dokumentet janë të leshuara nga i njejt organ dhe qendron pretendimi siq e ka specifikuar në pretendim OE ankues se licenca nuk leshohet per kopanit që posedojn „ Leja Mjedisore e integruar”Impianti për asgjësimin e mbeturinave spitalore ,medicinale ,organike të përgjithëshme,sepse e njejta është percaktuar me ligjë .

AK në raste të tlla me dokumente ekivalente nese ka hezitim mundë te kerkojë informacion nga leshuesit e atyre dokumebteve per tu siguruar se i permbush apo jo kushtet e parapara me Licencë edhe per ofertuesit që kanë aplikuar me dokumente ekivalente siq ishte rasti me Leja Mjedisore e integruar”Impianti për asgjësimin e mbeturinave spitalore ,medicinale ,organike të përgjithëshme,e pas marrjes së informacionit nga organi kompetent të vendosë në menyre të sigurt se vlen apo jo dokumenti ekuivalent.

Eksperti sqaron se si pretendim është i bazuar por i njejt nuk ndikon në rezultatin perfundimtar të fituesit sepse siq u sqarua më lart kemi pretendim tjetër të pa bazuar. Andaj,eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuarë. E sa i perket pretendimit për shkeljen e nenit 59 të LPP-së si pretendim është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.5.

OE ankues ”Met Bat SH.P.K.”- Gllgoc - pretendon se Autoritetit Kontratues Ministria e Shendetësisë e ka shkelur nenin 60 të LPP-së. Eksperti thekson se qellim i ketij neni është vendosja e kriterit per dhenje të kontrates,ku kriter ishte tenderi i pergjegjëshëm me çmim më te ulët. OE ankues pretendon se nuk është respektur kriteri kryesor i parapar me nenin 1.1 i nenit 60 sepse ka qen kriter tenderi i pergjegjëshëm me çmim më te ulët .

Ekspertit sqaron se i njejt pretendim nderlidhet me pretendimet e tjera dhe pasi kishte pretendime qe nuk ishin te pranueshme,ky pretendim nderlidhet edhe me ato pretendime , dhe del të jetë si pretendim i pa pranueshëm. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i pa bazuar .

Përgjigje në Pretendimi nr.5 dhe 6.

OE “Met Bat SH.P.K.”- Gllgoc - pretendon se Autoritetit Kontratues Ministria e Shendetësisë e ka shkelur nenin 64 Dëshmit e Kerkesave dhe nenin 69 të LPP-së ,

Eksperti thekson se qellim i ketij neni është të behet verifikimi i pershtatshmerisë profesionale dhe vlerësimi të bëhet mbi aftësinë teknike dhe profesionale te kerkuara dhe te specifikuara me dosjen e tenderit dhe NJK.

Eksperti sqaron se OE ankues nuk ka berë ndonjë specifikim konkret per sa i perket ketyre dy neneve mirëpo te njejtat nderlidhen me pretendimet per shkeljen e nenit 59 te permendura në pergjigjëjen nr 4 te kesaj ekspertize dmth pergjigjejen e gjeni te pretendimi nr.4 pika 1 dhe pika 2.

Andaj, Eksperti konstaton se keto pretendim janë pjesërisht të bazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, (për arsytet që u cekën të përgjigjëjet në secilin pretendim) dhe i rekomandon panelit shqyrtues që ta lë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues, Paneli Shqyrtues konstaton se në trajtimin e kësaj ankese do të ndalet tek pretendimi ankimor që ka të bëjë me pikën 2 të eliminimit sepse OE nuk ka plotësuar kërkesën nr. 4 lidhur me përshtatshmërinë profesionale, konkretisht nuk e ka ofruar Licencën e kërkuar, por ka ofruar një leje mjedisore e cila nuk e plotësor kërkesën e tenderit, si pikë kyçe e cila përcakton rrjedhën e vendim-marrjes përfundimtare, andaj PSH nuk e konsideron të nevojshme që pretendimet tjera lidhur me këtë OE të shqyrtohen në detaje. Kjo pikë e eliminimit sa i përket licencës së kërkuar në Dosje të Tenderit është trajtuar edhe në lëndën 281/22, kundrejtë kësaj licence dhe pikërisht ndaj këtij OE ankues në një aktivitet tjetër të prokurimit dhe autoritet tjetër kontraktues, por çështja e konstitit është e njëjtë. Andaj, PSH konstaton se OE nuk ka plotësuar kërkesën nr. 4 lidhur me përshtatshmërinë profesionale, konkretisht nuk e ka ofruar Licencën e kërkuar sipas Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, me që e ka hartuar dosjen e tenderit në pajtim me kërkesat e domosdoshme, të parashikuara shprehimisht me dispozitën e nenit 27 (Dosja e Tenderit) lidhur me nenin 28 (Specifikimet teknike) të Ligjit të cituar kurse kriteret e aplikuar dhe veprimet e ndërmarra nuk karakterizohen me natyrë diskriminuese. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat

relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - MetBat SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: